

Hyrja në aplikacion për herë të parë

Për hyrjen tuaj në aplikacionin e Formularit të regjistrimit të Kërkesës për Mbrojtje Ndërkombëtare do të duhet të ndiqni hapat që përshkruhen si vijon.

Hapat 1 & 2 do të shfaqen çdo herë që hyni në aplikacion.

KUJDES: Nëse jeni nën 18 vjeç dhe nuk jeni i/e shoqëruar nga një i rritur i cili është përgjegjës për përkujdesjen tuaj sipas legjislaturës greke, nuk duhet të vazhdoni plotësimin e Formularit në mënyrë elektronike. Për kryerjen e procedurës, duhet t'i drejtoheni shërbimit kompetent.

Hapi 1: IDENTIFIKIMI

| | |
|---|---|
| Numri i Kërkesës paraprake (regjistrimit paraprak) për Azil. | Plotësoni numrin e Kërkesës Paraprake (regjistrimit paraprak) për Azil, i cili ju është dhënë nga shërbimi kompetent dhe referohet në dokumentet zyrtare të cilat ju janë lëshuar nga shërbimi kompetent. |
| Mbiemri | Plotësoni dy (2) gërmat e para të mbiemrit tuaj me shkronja latine të mëdha sikurse i keni deklaruar pranë shërbimit kompetent gjatë procedurës së regjistrimit tuaj fillestar dhe sikurse referohen në dokumentet zyrtare të cilat ju janë lëshuar nga shërbimi kompetent. |
| Emri | Plotësoni dy (2) gërmat e para të emrit tuaj me shkronja latine të mëdha sikurse i keni deklaruar pranë shërbimit kompetent gjatë procedurës së regjistrimit tuaj fillestar dhe sikurse referohen në dokumentet zyrtare të cilat ju janë lëshuar nga shërbimi kompetent. |
| Datëlindja | Plotësoni datëlindjen tuaj sikurse e keni deklaruar pranë shërbimit kompetent gjatë procedurës së regjistrimit tuaj fillestar. Regjistroni në formatin d/m/vvvv, për shembull 1 Shkurti 2000, duhet të shkruhet 01/02/2000 ose 1/2/2000. |
| Nr.telefoni mobil | Plotësoni numrin e telefonit mobil grek në të cilin dëshironi t'ju dërgohet kodi me një përdorim për hyrjen në aplikacion.Kodin duhet ta vendosni në Hapin 2, për të vazhduar. |
| Unë nuk jam një robot | Plotësoni simbolet që shihni në imazh. Përfshihen shkronja dore latine dhe numra. Nëse teksti është i palexueshëm, ju mund të kërkonte një tjetër duke klikuar butonin «Rifreskoni captcha» («Ανανέωση captcha»). |

Hapi 2: VENDOSJA E KODIT

Klikoni «Hyrje» («Είσοδος») në ekranin e identifikimit, dhe pas identifikimit me sukses, do t'ju kërkohet të plotësoni kodin gjashtëshifror me një përdorim i cili ju është dërguar në telefonin mobil që keni deklaruar në Hapin 1.

Hapi 3: GJUHA

Pas vendosjes me sukses të kodit me një përdorim, duhet të zgjidhni **gjuhën**, në të cilën dëshironi të plotësoni Formularin.

KUJDES: Kjo zgjedhje është e pandryshueshme. Në rast se dëshironi të ndryshoni gjuhën e plotësimit, të gjitha fushat e Formularit do të shuhet dhe do të duhet të plotësohen nga fillimi.